



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA KLOS**  
**KËSHILLI BASHKIAK KLOS**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 18, si dhe në Ligjin Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” për garantimin e pjesëmarrjes publike në procesin e vendimmarrjes, dhe në VKM nr.247, datë 30.04.2014 “ Për përcaktimin e rregullave të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.

**NJOFTOJMË:**

Këshilli i Bashkisë Klos organizon dëgjese publike, tek salla e Bibliotekës Klos datë 18.04.2024 ora 13: 00 , me grupin e interesit subjektet tregtare që ushtrojnë aktivitet në qytetin e Klosit si dhe me komunitetin. Mbi propozimin e subjekteve tregtare që ushtrojnë aktivitet, për të kaluar si ditë të zhvillimit të tregut në qytetin e Klosit, nga dita e Dielë e çdo jave në ditën e Shtunë të çdo jave.

**Propozuesi:** Konsultimi publik u propozua nga Këshilli Bashkiak Klos.

**Sqarime:** Kërkesa për ndryshimin e ditës së zhvillimit të tregut në Qytetin e Klosit, nga dita e Dielë e çdo jave , në ditën e Shtunë të çdo jave është paraqitur e firmosur nga subjekte tregtare dhe shërbime me argumentin që: Qytetet fqinje, e zhvillojnë tregun çdo ditë të Shtunë të javës dhe e diela e tyre është pushim, shitës ambulant nga qytetet fqinje e shfrytëzojnë ditën e dielë në Klos për të zhvilluar aktivitetin e tyre sekondarë, duke kërcënuar aktivitetin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në Klos. Dita e Dielë, bazuar në nenin 85 i kodit të punës duhet të jetë ditë pushimi.

**Kalendari i konsultimit:** Mbledhja e mendimeve dhe rekomandimeve të komunitetit do të bëhet përmes komenteve në email të sekretarit të këshillit [etmondemiri1@hotmail.com](mailto:etmondemiri1@hotmail.com) si dhe në adresën postare për 10 ditë rresht dhe gjatë konsultimit.

**Pjesëmarrës:**

- **Nga ana e Bashkisë:** Këshilli i Bashkisë, këshilltarë.
- **Nga komuniteti:** Banorët, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias, Kryetarët e Fshatrave dhe Ndërlidhësit Komunitarë.

**Format e konsultimit:** Takim publik.

**Data e publikimit:** 02. 04. 2024